



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ  
KOMISIONI I POSAÇËM I RINDËRTIMIT

Nr. 1889 prot.

Kamëz, më 25.02.2025

VENDIM

Nr. 1889, Datë 25.02.2025

“PËR

TRAJTIMIN E APLIKIMIT TË Z. YLLI DEMIRAJ”

Në mbështetje të Ligiit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në zbatim të Aktit Normativ nr. 9, datë 06.12.2019 “Për Përballimin e Pasojave të Fatkeqësisë Natyrore” dhe akteve të tjera nënligjore dalë për zbatim të tij, Komisioni i Posaçëm i Rindërtimit për Objektet Kolektive ngritur me anë të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr. 492, datë 21.05.2024 “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 978, datë 27.12.2022, Mbi ngritjen e Komisionit të Posaçëm të Rindërtimit për Objektet Kolektive, i ndryshuar, në mbledhjen e datës 28.01.2025 si dhe në vijimësi të diskutimeve të zhvilluara në mbledhjen pasardhëse të datës 18.02.2025, Komisioni mori në shqyrtim dokumentacionin që administrohet në dosjen e krijuar në kuadër të Programit të Rindërtimit të përcjellë nëpërmjet shkresës nr. 676 prot, datë 21.01.2025, me lëndë: “Kërkesë për bashkëpunim”, nga Drejtoria e Rindërtimit dhe Legalizimeve, për subjektin aplikues Z. Ylli Demiraj.

Pas shqyrtimit të aplikimit të Z. Demiraj dhe dokumentacionit të dorëzuar prej tij nga Drejtoria e Rindërtimit, Komisioni i Posaçëm për Objektet Kolektive të Rindërtimit, rezulton se:

- Me shkresën nr. 1716 prot., datë 21.02.2023, me lëndë: “Kërkesë”, Z. Ylli Demiraj ka aplikuar për të përfituar nga programet e rindërtimit.
- Me anë të shkresës nr. 676 prot., datë 21.01.2025, me lëndë: “Kërkesë për bashkëpunim”, Drejtoria e Rindërtimit i është drejtuar Komisionit të Posaçëm të Rindërtimit me qëllim shqyrtimin e rasteve të patrajuara nga procesi i rindërtimit.
- Me shkresën nr. 4748/1 prot., datë 27.09.2022, me lëndë: “Përgjigje ndaj kërkesës për informacion”, në bazë të sistemit dhe të dhënave që KESH disponon rezulton se abonenti Ylli Demiraj figuron me kontratë të energjisë elektrike deri në periudhën 31.12.2006, me kontratën nr. 448077, me adresë Valias, Kamëz.
- Me shkresën nr. 2096 prot., datë 23.09.2022, me lëndë “Vërtetim”, konfirmohet se Z. Ylli Demiraj disponon kontratë kontratë me nr. 0010509, me UKK Kamëz SHA për periudhën deri në datën 06.01.2017, me adresë në rrugën “Adbi Bej Toptani” Valias.



Në aktin normativ nr. 9, datë 06.12.2019, përcaktohet se marrëdhënia juridike që duhet të ketë individi/familja përfituese me banesën e dëmtuar, duhet të jetë marrëdhënie pronësie apo posedimi. Në këtë linjë argumentimi shkon edhe Vendimi i Këshillit Bashkiak Kamëz nr. 90, datë 03.08.2020 “Për miratimin e vërtetimit të lëshuar nga kryetari i fshatit dhe administratori i njësisë administrative dhe lagjeve si pjesë e dokumentacionit të dosjes së aplikuesit për të përfitur nga programet e rindërtimit”, i cili ka vendosur:

1. Pranimin si pjesë e dokumentacionit të dosjes së aplikuesit për të përfitur nga programet rindërtimit Vërtetimin e lëshuar nga kryetari i fshatit dhe administrator i njësisë administrative dhe lagjeve në cilësinë e dokumentit që vërteton posedimin e banesës/objektit në momentin e rënies së termetit.
2. Kontrata e energjisë dhe/ose kontrata e shërbimit me ujësjellësin si pjesë e dokumentacionit provues, duhet të jenë (pesë) vjeçare nga momenti i nënshkrimit dhe në asnjë rast të mos jenë të nënshkruara pas datës 26.11.2019.

Përsa më sipër, nëpërmjet kësaj vendimarrje me karakter normativ, Bashkia Kamëz ka pranuar si përfitues subjektet posedues të banesave të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore me kusht që posedimi të provohet se është i qëndrueshëm (referuar kohëzgjatjes së kërkuar të marrëdhënieve të furnizimit me energji elektrike dhe ujë).

Nga dokumentacioni fizik në dosje, Z. Ylli Demiraj nuk provon posedimin në mënyrë të qëndrueshme në ndonjë banesë në pallatin e dëmtuar. Mungon një vërtetim fakti që të provojë posedimin në momentin e ndodhjes së termetit, në mënyrë që të përfshinte dhe periudhën e ndërmyetme kur ka shkëputje.

Në përfundim të vlerësimit të rastit konstatojmë se në kuadër të procesit të rindërtimit për rehabilitimin e komuniteteve dhe rindërtimit të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore mbështetur në Aktin normative nr. 9, datë 16.12.2019 dhe aktet ligjore të dala në zbatim të tij; Komisioni i Posaçëm i Rindërtimit për Objektet Kolektive, vlerëson se Z. Demiraj nuk përmbush kriteret ligjore për të përfitur nga ky program.

**Sa më sipër,**

## **KOMISIONI I POSAÇËM I RINDËRTIMIT PËR OBJKTET KOLEKTIVE**

### **VENDOSI:**


1. Të mos kualifikojë subjektin Z. Ylli Demiraj pasi nuk gjendet përpara fakteve dhe kriterëve ligjore për kualifikimin si kategori përfituese nga program i rindërtimit.

2. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet për njoftim subjektit aplikues Z. Ylli Demiraj.


**Eni Bistri**



**Eronit Lama**



**Erlend Baballëku**



**Vjollca Smaçi**



**Flora Muça**

